REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

**Data:** 10 Mars 2021 | **Nr: 124**

# VENDIM

## PËR KTHIMIN PËR KORRIGJIM TË DOKUMENTACIONIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR DEPUTET TË DEPOZITUAR NGA PARTIA "ALEANCA DEMOKRACIA E RE" PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS 25 PRILL 2021

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, 67, 72 dhe 73, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit",

**V Ë R E J:**

Partia "Aleanca Demokracia e Re" është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Në bazë të neneve 67 e 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, Partia "Aleanca Demokracia e Re" ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore për 12 zona zgjedhore.

Në bazë të nenit 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për deputet të Partisë "Aleanca Demokracia e Re" dhe dokumentacionin bashkëngjitur. Në përfundim të procesit të verifikimit paraprak u konstatuan mangësi dhe mospërmbushje të dokumentacionit si më poshtë:

1. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Tiranë,** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkaluar numrin e kërkuar me 6 kandidatë;

2. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Vlorë,** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkaluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
3. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Dibër,** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkaluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
4. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Elbasan,** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkaluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
5. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Korçë** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkaluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
6. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Kukës,** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkaluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
7. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Shkodër,** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkaluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
8. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Durrës,** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkaluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
9. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 14 z. Gjergji Nole, **Qarku Tiranë**, faqja 3 mungon emri, mbiemri dhe nënshkrimi i kandidatit.

Në bazë të nenit 73 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dokumentacioni i depozituar kthehet për korrigjim subjektit zgjedhor, Partia “Aleanca Demokracia e Re”.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe Udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

**V E N D O S :**

1. Kthimin për korrigjim, sipas gjetjeve të renditura më sipër, të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet, të Partisë "Aleanca Demokracia e Re", për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.
2. Dokumentacioni i korrigjuar të depozitohet brenda datës 16.03.2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASH**